



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K..Dh.Shk.II.nr.1006/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike të kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave me seli në Prishtinë, kundër debitorit Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë, për shkak të pagesës së borxhit, në bazë të dokumentit të besueshëm faturës, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.200/22 të datës 30.05.2023, jashtë seancës me datën 17.11.2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e kreditorit Komisioni i Pavarur i Mediave me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, KPPP.nr.200/22 i datës 30.05.2023, Vërtetohet

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin KPPP.nr.200/22 të dt. 30.05.2023 e ka Pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë dhe ka Anuluar urdhrin përmbartimor P.nr.1177/19 dt.08.07.2019 i lejuar nga përmbartuesi privat Destan Bujupaj

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori, me të cilën e ka kontestuar në tërësi si të pabazuar aktvendimin KPPP.nr.200/22 i datës 30.05.2023, për shkak se gjykata e shkallës së parë nuk ka shqyrtuar pretendimet e kreditorit sa i përket pranimit të faturës në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Komisioni i Pavarur i Mediave me seli në Prishtinë, me datën 08.07.2019, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të përmbarrimor – faturës nr.002302 datës 12.02.2019, për shumën e detyrimit prej 20,000.00€, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj me seli në Prishtinë, me Urdhrin Përmbarrimor P.nr.1177/19 të dt.08.07.2019, ka caktuar përmbarrimin, duke vlerësuar se dokumenti përmbarrimor, i plotëson kushtet për përmbarrim, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës përmbarrimore.

Debitori Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë, ka ushtruar prapësim, duke theksuar se dokumentet e bashkangjitura propozimit për përmbarrim nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm sikurse është paraparë me nenin 29 të LPP-së, dhe se fatura kontestuese nuk është e bashkangjitur në origjinal apo kopje e vërtetuar, ka propozuar që të aprovohet prapësimi dhe të shfuqizohet urdhri përmbarrimor P.nr.1177/19 dt.08.07.2019.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar pala kreditore KPM në Prishtinë, duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, duke theksuar se fatura mbi bazën e së cilës është lejuar përmbarrimi i plotëson të gjitha elementet e përcaktuara për secilën organizatë buxhetore, pasi që kreditori si organizate profitabile nuk vepron në bazë të Ligjit të ATK-së, ashtu që të hyrat tek kreditori derdhen direkt në buxhetin e shtetit. Nga prapësimi i debitorit shihet se qëllimi i tij është vetëm shtyrja apo prolongimi i pagesës së borxhit me pretekstin se fatura nuk është e nënshkruar, i propozon gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet ndërsa urdhri përmbarrimor P.nr.1177/19 datës 08.07.2019 të mbetet ne fuqi.

Dhoma e shkallës së parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.200/22 të datës 30.05.2023, me të cilin e ka Pranuar në tërësi si të bazuar prapësimin e debitorit Telekom i Kosovës me seli në Prishtinë, dhe ka Anuluar urdhrin përmbarrimor P.nr.1177/19 dt.08.07.2019 i lejuar nga përmbarruesi privat Destan Bujupaj

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar Dhoma e shkallës së parë, ka theksuar se fatura nr.002302 datës 12.02.2019 nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se e njëjta nuk përmban nënshkrimin apo vulën e debitorit si institucion, andaj nuk mund të vërtetohet se fatura është pranuar në mënyrë të rregullt nga ana e debitorit. Kreditori nuk ka bashkangjitur asnjë provë nga e cila dëshmohet se fatura është dozuar në ndonjë formë tjetër tek debitori. Gjykata vendimin e referon ne nenin 29, 37 dhe 71,73 të LPP-së, nenin 12 par.2 të Ligjit 05/L-118.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka aprovuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturës së lëshuar nga

kreditore, e cila faturë nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”* ne rastin konkret fatura madje është kopje dhe jo origjinal apo kopje e vërtetuar siç kërkohet dispozitat ligjore.

Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se Dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim ne pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të Dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Dhoma e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë rezultoi se aktvendimi i ankimuar është i drejtë dhe i bazuar. Dhoma e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili ne nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që *“Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*, konsideron se fatura si dokument në sajë të së cilës kreditore kërkon përmbushjen e detyrimit nga debitori, nuk është e vulosur nga debitori e as e nënshkruar nga ana e tij dhe se e njëjta është kopje, ne mënyrë që të konsiderohet si dokument i besueshëm, andaj vlerëson se me te drejtë Dhoma e shkallës së parë ka vlerësuar se kreditore ne rastin konkret nuk ka ofruar prova juridikisht te vlefshme në mbështetje te pretendimeve te tij.

Dhoma e shkallës së dytë i konsideroi të pabazuara pretendimet ankimore të kreditore i cili kërkon që shkresa e licencimit Ref:1901/003/LIC/ni, të konsiderohet si dëshmi së debitori ka pranuar faturën e borxhit. Ky pretendim ankimor nuk gjen mbështetje në dispozitat ligjore, pasi që propozimi për përmbartim është iniciuar në bazë të faturës përmbartimore nr.002302 dt.12.02.2019 si titull përmbartues, ndërsa shkresa e cekur si më lartë nuk mund te konsiderohet si dokument përmbartimor nga neni 21 dhe 22 i LPP-së.

Kompetenca e Dhomës se Shkallës se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II nr.1006/23 datë 17.11.2023

Gjyqtari
Krenar Berisha